



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1373/6 prot.

Datë 20.05.2026

V E N D I M
Nr. 675/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2026 shqyrtoi ankesën me objekt:

Objekt: Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, *Mallra*, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK me NIPT M31904013D. *Adresa: “Rruga e Dibrës”, Vila 153, Kati I, Z.K. nr.8370,1001, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rr. “Osman Haxhiu”, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Mallra, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6614, datë 04.05.2026 dhe me nr. 1373/2026 prot., datë 05.05.2026 i operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, mbi modifikime të dokumenteve të tenderit.

II.3. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike Autoriteti Kontraktor ka përcjellë shkresën nr. 8811/2 prot., datë 07.05.2026, protokolluar me tonën me Nr. 1373/1 prot., datë 08.05.2026, me anë të së cilës informon mbi Vendimin e KSHA-së, në lidhje me ankesën, duke vendosur pranim të pjesshëm të pretendimeve të ankesës.

II.4. Me shkresën e ardhur në Sistem me datë 14.05.2026, “Argument Shtesë”, operatori ekonomik kundërshton Vendimin e KSHA-së për mospranim të pretendimeve të ankesës dhe rithekson pretendimet e tij mbi mangësi në hartimin e DST-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

Ankesa 1. Autoriteti Kontraktor nuk ka publikuar si pjesë të dokumentacionit të tenderit Procesverbalin tip të kontratës mallra Për argumentimin dhe miratimin e termave të references dhe kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 Për prokurimin publik i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Mungesa e Procesverbalit të Argumentimit ka krijuar klimë kufizuese dhe mosbesimi për konkurrencën e lirë në procedurat e prokurimit publik

Kërkesa 1: Autoriteti Kontraktor të ndërmarrë masat e nevojshme për publikimin e procesverbalit, Për argumentimin dhe miratimin e termave të references dhe kriterëve për kualifikim,

KSHA me Vendimin nr. 8811/2 Prot datë 07.05.2026 ka sqaruar se:

Dokumenti PROCESVERBAL ARGUMENTIMI është i publikuar dhe i aksesueshëm si pjesë e Dokumenteve të Njoftimit në SPE.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së, ka vendosur pranim të pjesshëm të pretendimeve të ankesës sipërcituar.

III.1.2. Referuar Nenit 30 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Neni 115 pika 1 dhe 3 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin;

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankumuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.3. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik si edhe Vendimit të KSHA-së, mbi pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni do të mbyllë shqyrtimin e pjesës së pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Mallra, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të ngritura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

Ankesa 2: Autoriteti Kontraktor në DST dhe specifikimet teknike ka **kërkuar mirëmbajtje** për zërat objekt prokurimi, por nuk ka përfshirë zërin e mirëmbajtjes në shtojcën 2 Listën e çmimeve sipas zërave të preventivit, shojcën 6 grafiku sipas kërkesave të AK, Shtojcën 10 Preventivi.

Shërbimi i mirëmbajtjes one-site NBD (Next Business Day) për 4 vendparkime, me reagim 24/7 brenda 120 min në distancë, me personel teknik të disponueshëm 5 ditë në javë për 12 muaj, paraqet një kosto reale, të konsiderueshme dhe të matshme ku përfshihen kostot njerëzore, kostot operationale, logjistika organizimi, disponueshmëria e një ekipi specifikisht për këtë project etj.). Megjithatë, ky shërbim i cili mbart kosto të konsiderueshme financiare per Operatoret Ekonomike nuk figuron si zë i veçantë me çmim në asnjë nga shtojcat:

• Shtojca 2, Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit • Shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK-së • Shtojca 10, Preventivi

AK nuk ka parashikuar ne DST Shtojca 2, Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit, Shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK-së, Shtojca 10, Preventivi, Zerin “Mirembajtje”, duke krijuar kushte pabarazie dhe diskriminimi per OE-te, te cileve u kerkohet te paraqesin nje oferte ekonomike te paplote, ne te cilen nuk përfshihen ne menyre shteruese te gjitha zerat e kerkuara te sherbimeve/mallrave per te cilat AK ka publikuar kete procedure prokurimi. Akoma me tej, mirembajtja ze nje peshe te konsiderueshme ne kete procedure prokurimi, krijohen paqartesi mbi menyren si eshte perlllogaritur fondi limit, a jane marre ne konsiderate te gjitha kostot, a krijohen kushte per kosto te fshehura permes publikimit te

dokumentave jo shterues dhe te paplote? Sjellim ne vemendje te AK se kriteret e hartuara i referohen nje sherbimi te mirefillte mirembajtjeje, i cili duhet detyrimisht te trajtohet si ze i vencante ne oferten ekonomike.

Si me poshte po ju sqarojme diferencat thelbësore qe ka nje Mirembajtje nga nje Garanci.

Garancia është detyrim ligjor i prodhuesit/furnizuesit që rrjedh automatikisht nga akti i shitjes. Ajo garanton se pajisja ose softueri do të funksionojë sipas specifikimeve teknike të deklaruara për një periudhë të caktuar kohe. Garancia nuk ka kosto shtesë është e përfshirë në çmimin e pajisjes dhe aktivizohet vetëm kur pajisja dështon për defekt të prodhimit ose materialit, jo për shkak të përdorimit të gabuar apo kushteve të jashtme. Garancia mbulon: zëvendësimin e pjesëve me defekt prodhimi, riparimin e defekteve fabrike, përditësimet e firmëareut të detyrueshme për funksionim korrekt. Garancia nuk mbulon: dëmtimet nga keqpërdorimi, kushtet e papershtatshme ambientale, konfigurimin e sistemit, mbështetjen operative ditore, trajnimin e stafit.

Mirëmbajtja është shërbim i veçantë dhe i pavarur që ofrohet përtej garancisë dhe ka kosto të mirëfilltë ekonomike. Ajo mbulon tërësinë e veprimeve proaktive dhe reaktive për të mbajtur sistemin funksional në nivelin e kërkuar operacional, përfshin alokim periodic resursesh njerezore dhe operationale, pavarësisht nëse ka defekt ose jo. Mirëmbajtja mbulon: monitorimin periodik të sistemit, inspektimet parandaluese, përditësimet e softuerit dhe konfigurimit, reagimin ndaj çdo problemi operacional brenda afateve të SLA-së (rasti konkret 120 minuta), disponueshmërinë e personelit teknik 5 ditë/javë, përgatitjen e dokumentacionit te ndërhyrjeve.

Konkretisht, klauzola e mirëmbajtjes kërkon reagim brenda 120 minutave dhe personel teknik të disponueshëm, i cili përfshin shërbim aktiv me kosto reale personeli, i cili nuk mund të jetë kurrësi i përfshirë automatikisht në çmimin e një pajisjeje/softueri.

Ndërkohë, garancia ne vetvete perfaqeson nje gjendje pasive e cila aktivizohet vetëm ne raste defekti te pajisjes dhe si rregull mbulohet nga termat e garancise se prodhuesit. Kërkesa 2:

Autoriteti Kontraktor te marre masat e nevojshme per pasqyrimin e sherbimit te kerkuar te mirembajtjes si ze te vecante ne:

- Shtojca 2, Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit
- Shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK-së
- Shtojca 10, Preventivi

III.2.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST

- Objektin e Pokurimit **“Sistem i Parkimit per “Vlora Parking”**.
- Dokumentin “Specifikimet Teknike” ku ndër të tjera ka specifikuar:

Mirëmbajtja	
Përshkrimi i përgjithshëm:	Shërbimi i mirëmbajtjes duhet të përfshijë periudhë minimalisht 1 vjeçare.
Koha e reagimit :	Shërbimi i mirëmbajtjes dhe suportit teknik duhet të ketë terma: - Koha e reagimit nga distanca minimalisht brenda 120 minutash nga marrja e telefonates apo kerkeses nga stafi i AK ; - Koha e reagimit ne vend minimalisht brenda dites tjeter te punes nga marrja e telefonates apo kerkeses nga stafi i AK. Operatorët ekonomik duhet te vendosin ne dispozicion kontaktet zyrtare te zyres se suportit teknik, nje adrese emaili per komunikime me shkrim si edhe kontakt te perfaqesuesit ligjor te kompanise ne rast komunikimi per mos-pergjigje apo mungese reagimi nga ana e stafit teknik te suportit.

GARANCIA

Garancia minimale e kërkuar për pajisjet dhe programet është 1 vit. Procedurat përgjatë kësaj periudhe duhet të jenë sikurse përshkruar më poshtë.

MIRËMBAJTJA

Termat e mirëmbajtjes

Mirëmbajtja që duhet të ofrohet gjatë periudhës së garancisë duhet të sigurojë marrjen e të paktën shërbimeve të mëposhtme:

- Garanci për të gjitha pajisjet në termat on-site Next Business Day;
- Gatishmërinë e suportit 5 (pesë) ditë në javë, gjatë orarit zyrtar.

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT SIPAS KËRKESAVE TË AK

Afatet e realizimit të kontratës : 14 ditë

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Afati Ditor
1	Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës së parkimit, me ekran dhe aksesore	Set	4	14 Ditë
2	Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore	Set	4	14 Ditë
3	Pajisje bariere për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi parkimit)	Set	8	14 Ditë
4	Pajisje për leximin e biletave	Copë	4	14 Ditë
5	Software qendror për menaxhimin e qendëruar të sistemit të parkimit	Set	4	14 Ditë
6	Pajisje kompjuter për instalimin e programit, monitor	Copë	4	14 Dite
7	Pajisje kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit	Copë	4	14 Dite
8	Kamera te jashtme	Copë	33	14 Ditë
9	Kamera e brendshme me audio	Copë	4	14 Ditë
10	DVR me 16 kanale	Copë	2	14 Ditë
11	DVR me 12 kanale	Copë	2	14 Ditë
12	Integrim me shërbim fiskalizimi	Set	4	14 Ditë
13	Leter parkimi, komatibel me sistemin e parkimit	Rulona	500	14 Ditë
14	Karta RFID	Copë	80	14 Ditë
15	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë
16	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë

17	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë
18	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë
19	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike e përkulshme 720 mm*705mm (H*W)	Copë	20	14 Ditë
20	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike 1020mm*1105mm (H*W)	Copë	100	14 Ditë
21	Sistem i qendërzuar i menaxhimit për raportim dhe analizim	Set	4	14 Ditë

Shtojca 10.

PREVENTIVI

SISTEMI PARKIMIT NË SHESHE (lekë)					
Nr	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi	Total pa Tvsh
1	Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës së parkimit, me ekran dhe aksesore	Set	4		
2	Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore	Set	4		
3	Pajisje bariere për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi parkimit)	Set	8		
4	Pajisje për leximin e biletave	Copë	4		
5	Software qendror për menaxhimin e qendërzuar të sistemit të parkimit	Set	4		
6	Pajisje kompjuter për instalimin e programit, monitor	Copë	4		
7	Pajisje kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit	Copë	4		
8	Kamera të jashtme	Copë	33		
9	Kamera e brendshme me audio	Copë	4		
10	DVR me 16 kanale	Copë	2		
11	DVR me 12 kanale	Copë	2		
12	Integrim me shërbim fiskalizimi	Set	4		
13	Letër parkimi, kompatibël me sistemin e parkimit	Rulona	500		
14	Karta RFID	Copë	80		
15	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1		
16	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1		
17	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1		

18	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1		
19	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike e përkulshme 720 mm*705mm (H*W)	Copë	20		
20	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike 1020mm*1105mm (H*W)	Copë	100		
21	Sistem i qendëruar i menaxhimit për raportim dhe analizim	Set	4		
	Totale pa Tvsh				
	Me Tvsh 20%				
	TOTAL SHUMA				

III.2.2. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës..

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.3. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim/specifikime teknike, gjithnjë kur ato janë të nevojshme

dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Autoriteti kontraktor duhet të pasqyrojnë saktë dhe qartë nevojat për vitin kalendarik pasardhës, përcaktimin e procedurave të prokurimit, hartimin e dokumentacionit në përputhje me kërkesat për blerje mallra apo shërbime, në mënyrë të tillë që të orientojnë operatorët ekonomikë të hartojnë ofertat e tyre, të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.2.5. Referuar pretendimeve të ankesës, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimit dhe vëren, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka përcaktuar objektin e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, *Mallra*, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, dhe kërkesa që pajisjet të shoqërohen me garanci për periudhën 1 vit, është e drejtë e Autoritetit, i cili kërkon siguri mbi cilësinë dhe mirëfunksionimin e pajisjeve që prokuron, e në rast defektesh që nga prodhimi të cilat mund të shfaqen përgjatë periudhës së garancisë, AK përfiton shërbimin e riparimeve apo zëvendësimeve të natyrave të ndryshme sipas kushteve të përcaktuara, ku shitësi përgjigjet për defektet e pajisjeve në kuadër të përcaktimeve të shprehura në Fletë Garanci për pajisjet objekt prokurimi.

Referuar dokumenteve të tenderit Komisioni vëren, se AK ka kërkuar të prokurojë blerje mallra dhe instalim e konfigurim të tyre dhe kërkesa për garanci 1 vit është mëse e arsyeshme e drejtë dhe në proporcion me elementet e procedurës së prokurimit.

Referuar dokumentit Procesverbal- tipi i kontratës – E hapur mallra, Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, publikuar në SPE, Komisioni vëren se AK nuk ka përcaktuar Mirëmbajtjen si zë më vete, por e ka cituar në brendi të kriterit 2.3.4. ku kërkohet garanci 1 vit për mallrat që prokurohen, argumentuar:

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme prej 1 viti, malli objekt prokurimi do të përmbushë specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat që mund të lindin, jo për faj të Autoritetit.

Gjithashtu Komisioni vëren se AK nuk ka argumentuar vendosjen e Shërbimit të Mirëmbajtjes në dokumentin e Specifikimeve Teknike, sipërcituar, çka do të thotë së kërkesat “**shërbim mirëmbajtje përcatuar në dokumentin Specifikime Teknike**” del jashtë objektit të prokurimit duke rezultuar si një kërkesë jo proporcionale me objektin e prokurimit, e paargumentuar e pa llogaritur si shërbim më vete, i cili kërkon kohë fizike dhe kosto, shërbim i paargumentuar në procesverbalin përkatës, duke rezultuar kërkesë konfuze dhe ngarkon operatorët ekonomikë me kosto shtesë të paplanifikuara dhe të paargumentuara nga autoriteti kontraktor.

Komisioni vlerëson të drejta argumentet e operatorit ekonomik i cili ka bërë nga krahasim midis termave si vijon:

Si me poshte po ju sqarojme diferencat thelbësore që ka një Mirembajtje nga një Garanci.

Garancia është detyrim ligjor i prodhuesit/furnizuesit që rrjedh automatikisht nga akti i shitjes. Ajo garanton se pajisja ose softueri do të funksionojë sipas specifikimeve teknike të deklaruara për një periudhë të caktuar kohe. Garancia nuk ka kosto shtesë është e përfshirë në çmimin e pajisjes dhe aktivizohet vetëm kur pajisja dështon për defekt të prodhimit ose materialit, jo për shkak të përdorimit të gabuar apo kushteve të jashtme. Garancia mbulon: zëvendësimin e pjesëve me defekt prodhimi, riparimin e defekteve fabrike, përditësimet e firmëareut të detyrueshme për funksionim korrekt. Garancia nuk mbulon: dëmtimet nga keqpërdorimi, kushtet e papershtatshme ambientale, konfigurimin e sistemit, mbështetjen operative ditore, trajnimin e stafit.

Mirëmbajtja është shërbim i veçantë dhe i pavarur që ofrohet përtej garancisë dhe ka kosto të mirëfilltë ekonomike. Ajo mbulon tërësinë e veprimeve proaktive dhe reaktive për të mbajtur sistemin funksional në nivelin e kërkuar operacional, përfshin alokim periodik resursesh njerezore dhe operationale, pavarësisht nëse ka defekt ose jo. Mirëmbajtja mbulon: monitorimin periodik të sistemit, inspektimet parandaluese, përditësimet e softuerit dhe konfigurimit, reagimin ndaj çdo problemi operacional brenda afateve të SLA-së (rasti konkret 120 minuta), disponueshmërinë e personelit teknik 5 ditë/javë, përgatitjen e dokumentacionit të ndërhyrjeve.

Konkretisht, klauzola e mirëmbajtjes kërkon reagim brenda 120 minutave dhe personel teknik të disponueshëm, i cili përfshin shërbim aktiv me kosto reale personeli, i cili nuk mund të jetë kurrësi i përfshirë automatikisht në çmimin e një pajisjeje/softueri

III.2.6. Në përfundim të analizës së fakteve Komisioni gjykon, se në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor përcakton nevojat që i duhen, ndaj duhet të hartojë kriteret dhe specifikimet teknike në funksion të procedurës objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë të planifikuara, mirëargumentuara, të përcaktuara qartë dhe saktë në objektin e prokurimit, shtojcat përkatëse, me qëllim që të orientojnë drejtë operatorët ekonomikë në përlllogaritjet dhe përgatitjen e ofertave të tyre. Gjithashtu hartimi i saktë i dokumenteve të tenderit, ndihmon autoritetin kontraktor me synim që të realizojë procedurën në kohë, me sukses dhe pa u bërë objekt ankesash nga operatorët ekonomikë.

Komisioni gjykon se Autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë qartë apo parashikuar **si zë më vete shërbimin e mirëmbajtjes** të pajisjeve objekt prokurimi, dhe kërkesa objekt ankimi rezulton një kërkesë e paqartë dhe konfuze për operatorët ekonomikë, e cila nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Autoriteti kontraktor të marrë masa për modifikim të DST sipas kërkesave të operatorit ekonomik, duke hequr kërkesën për shërbim mirëmbajtje.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.6 është kërkuar:

2.3.6 Deklaratë se merr përsiper trajnimet e stafit. Trajnimet duhet të organizohen nga personeli trajnues me eksperiencë dhe kërkohet të shoqërohen me materiale trajnimi të përgatitura për Bashkinë Vlorë.

Ndërsa në Specifikimet teknike, është kërkuar:

Trajnimet e Personelit Trainimet e realizuara ne kuadrin e ketij projekti, ne menyre te vecante, duhet te perfshijne module specifike per:

- Stafi i parkimit – rreth perdorimit te perditshem te sistemit
- Personelin teknik i Bashkise Vlore rreth teknologjise se programeve dhe pajisjeve si dhe procedurave standarde te operimit dhe te mirembajtjes. Trainimet duhet te organizohen nga personel trajnues me eksperience dhe kerkohet te shoqerohen me materiale trainimi te pregatitura per Bashkine Vlore, si dhe me pune praktike direkt ne sistem. Materialet si dhe trainimi kerkohet te zhvillohet ne nje ambjent te dedikuar per kete qellim si dhe te jene ne gjuhen shqipe.

Dokumentacioni i sistemit duhet te hartohet ne perputhje me zhvillimet dhe me instalimet specifike ne Bashkia Vlore dhe te jete ne gjuhen shqipe. Ofruesi duhet t'i levroje Bashkise Vlore minimalisht materialet e meposhtme: • Literaturen standarde te produkteve – duke perfshire komponentet specifike, te cilet trajtojne te gjitha kerkesat sipas specifikimeve ne keto kerkesa.

- Dokumentacionin teknik si dhe skemen e instalimit dhe konfigurimit te sistemit.
- Dokumentacion per suportin, operimin dhe mirembajtjen.
- Manualet e perdoruesve.

Autoriteti Kontraktor, ne dokumentin Specifikime Teknike, ka parashikuar shprehimisht dhe me detaje trajnime te detyrueshme. Gjithashtu, AK ka vendosur kushte te qarta organizative: "Trajnimet duhet te organizohen nga personel trajnues me eksperiencë dhe kerkohet te shoqerohen me materiale trajnimi te pregatitura per Bashkinë Vlorë, si dhe me pune praktike direkt ne sistem. Materialet si dhe trajnimi kerkohet te zhvillohen ne nje ambient te dedikuar per ketë qellim si dhe te jene ne gjuhën shqipe."

Sikurse Ankesa referuar sherbimit te mirembajtjes, dhe ky **shërbim nuk figuron si zë i veçantë me çmim në asnjë nga shtojcat:**

- Shtojca 2, Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit
- Shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK-së
- Shtojca 10,

Preventivi Trajnimet e kërkuara nga AK nuk janë trajnime simbolike. Ato përfshijnë dy grupe të ndryshme, disa module, materiale të dedikuara në gjuhën shqipe, ambiente të përshtatshme dhe instruktorë me eksperiencë, shërbime që kanë kosto reale dhe të matshme: pagesat e instruktorëve, prodhim materialesh didaktike, kosto mbi ambientet ku do zhvillohen trajnimet, kosto logjistike, operacionale. Mosparashikimi i tyre si zë financiar prodhon të njëjtat pasoja si në rastin e mirëmbajtjes: veshitësi në përgatitjen e ofertës ekonomike shteresuese nga OE, kosto te shtuara të papërfshira në fondin limit.

Kriteri krijon paqartesi mbi menyren si eshte perlllogaritur fondi limit, a jane marre ne konsiderate te gjitha kostot, a krijohen kushte per kosto te fshehura permes publikimit te dokumentave jo shterues dhe te paplote?

Sjellim ne vemendje te AK,se kriteret e hartuara i referohen nje sherbimi te mirefillte trajnimi i cili duhet detyrimisht te trajtohet si ze i vecante ne oferten ekonomike.

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST dokumentin Specifikime Teknike ku ka kërkuar:

TRAJNIMET E PERSONELIT

Trajnimet e realizuara në kuadrin e ketij projekti, në mënyrë të veçantë, duhet të përfshijnë module specifike për:

- Stafi i parkimit – rreth përdorimit të përditshëm të sistemit
- Personelin teknik i Bashkisë Vlorë rreth teknologjisë së

programeve dhe pajisjeve si dhe procedurave standarde të operimit dhe të mirëmbajtjes.

Trainimet duhet të organizohen nga personeli trajnues me eksperiencë dhe kërkohet të shoqërohen me materiale trajnimi të përgatitura për Bashkinë Vlorë si dhe me punë praktike direkt në sistem. Materialet si dhe trajnimi kërkohet të zhvillohet në një ambient të dedikuar për këtë qëllim si dhe të jenë në gjuhën shqipe.

Dokumentacioni

Dokumentacioni i sistemit duhet të hartohet në përputhje me zhvillimet dhe me instalimet specifike në Bashkinë Vlorë dhe të jetë në gjuhën shqipe.

Ofruesi duhet t'i levroje Bashkisë Vlorë minimalisht materialet e mëposhtme:

- Literaturën standarde të produkteve – duke përfshirë komponentet specifike, të cilët trajtojnë të gjitha kërkesat sipas specifikimeve në këto kërkesa.
- Dokumentacionin teknik si dhe skemen e instalimit dhe konfigurimit të sistemit.
- Dokumentacion për suportin, operimin dhe mirëmbajtjen.
- Manuallet e përdoruesve.

Dokumentacioni standard i produktit duhet të jetë në anglisht ose shqip.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, *se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik të ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

Bazuar në LPP, vendosja e kërkesave për kualifikim në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijë nga konkurrimi operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit apo të vendosin në vështirësi operatorët ekonomikë.

Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, ankesës së operatorit në lidhje me Trajnimin e Personelit të Institucionit, për realizimin e procedurës së prokurimit me furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve të sistemeve të parkimit, Komisioni gjykon se është e rëndësishme për autoritetin kontraktor dhe personelin që do të punojë në këto sisteme, të kërkojë një trajnim fillestar mbi funksionimin e pajisjeve objekt prokurimi, menaxhimin e tyre, zgjidhjen e problemeve të mundshme nga personeli si edhe një asistecë e përkohshme mbi përdorimin menaxhimin e pajisjeve.

Thënë qartë që Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë pjesërisht kërkesën objekt ankimi në lidhje me Trajnimet e Personelit duke mos i përcaktuar si trajnime të mirëfillta, impenjative sikurse ankimuesi argumenton me të drejtë ankesën e tij, por si trajnime apo asistencë mbi

vënien në punë dhe trajnim të punonjësve për funksionimin e pajisjeve, si edhe çdo pyetje apo problematika që mund të kenë për një periudhë kohore deri në përvetësimin e njohurive mbi përdorimin e pajisjeve objekt prokurimi.

Referuar arsytimit të sipërpërcitur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e operatorit ekonomik ankimes është pjesërisht e drejtë dhe e argumentuar dhe autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikim të specifikimit teknik objekt ankimi në lidhje me Trajnimet e Personelit, sipas parashikimeve sipërcituar.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentet si më poshtë vijon:

Ankesa 4: Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar afate realizimi të pamjaftueshme prej 14 ditë për të gjithë projektin, duke mos marrë parasysh natyrën, volumin, zërat objekt kontrate, si dhe duke mos konsideruar ndërvlerësinë që ka realizimi i projektit me palë/institucione të treta, lidhur me marrjen e lejeve, autorizimeve, zhvillimet e punimeve civile, afatet për verifikimin e disponueshmerisë së rrjetit nga OSHEE etj.

Autoriteti Kontraktor, në Shtojcën 6 të DST-së "Grafiku sipas Kërkesave të AK-së", ka parashikuar afat realizimi prej 14 (katërmëdhjetë) ditësh për furnizimin dhe instalimin e të gjithë sistemit të parkimit, duke përfshirë zërat Nr. 8 (33 kamera të jashtme) dhe Nr. 9 (4 kamera të brendshme), si dhe të gjithë zërat e tjerë objekt prokurimi. Ky afat është përcaktuar në mënyrë uniforme për të gjithë projektin, pa një analizë të mirefillte teknike apo kohore të vëllimit real të punës/shërbimeve. Gjykojmë se ky afat është teknikisht dhe logjistikisht i pamundur për realizim, për arsye të mëposhtme:

Së pari, natyra e projektit nuk është furnizim i thjeshtë mallrash. Sipas vetë dokumentacionit të tenderit të publikuar nga AK, objekti i kontratës nuk kufizohet në blerje dhe dorëzim pajisjesh, por përfshin furnizim, instalim, konfigurim dhe vënie në funksionim të një sistemi kompleks teknologjik.

Kjo rezulton qartë nga: Relacioni Teknik Elektrik, i cili parashikon instalim elektrik, tokëzim, dimensionim kabloje, lidhje me rrjetin OSHEE dhe sistem UPS emergjent;

Zërat 15-18 të Preventivit (Shtojca 2) të titulluar "Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativë parkimi Set", të cilët konfirmojnë se punët fizike të instalimit janë pjesë e detyrimeve kontraktuale;

Plani i Vendosies (Planimetritë A-04, A-07, A-10, A-13) të projektit të publikuar, i cili parashikon instalim kolona hyrjeje/dalje, barriera, spirale magnetike (loop detector) me prerje asfalti dhe kioska operatori në të 4 vendparkimet.

Punimet civile dhe koha e tharjes së betonit. Instalimi i kolonave të hyrjes dhe daljes, i barrierave dhe i kioskave të operatorit kërkon, sipas detajeve skematike të publikuara në Planimetrinë A-14 të projektit ("Detaje Skematike Barriera Ndarëse Urbane"), betonim paraprak të elementit mbajtës bazament të çdo kolone dhe barriere. Sipas Specifikimeve Teknike, kolonat "duhet të montohen në terren duke betonuar më parë një element mbajtës i cili duhet të funksionojë si bazament i kolonës". Betoni inëvojshëm për themelet e kolonave dhe barrierave nuk mund të ngarkohet strukturalisht pra kolona nuk mund të montohet dhe të vihet nën tension operacional përpara se të ketë arritur forcën minimale të nevojshme. Sipas standardeve teknike të zakonshme të ndërtimit, betoni arrin rreth 70% të forcës së tij nominale pas 7 ditësh kurim në kushte normale termike, dhe forcën e plotë pas 28 ditësh. Duke qenë se në 4 vendparkime duhen betonuar fondacionet e të paktën 8 kolonave aksesit (2 hyrje + 2 dalje × 4 parkingje), 8 barrierave dhe 4 kioskave operatori, punimet civile dhe

koha e kuruese e betonit zënë vetvetiu jo më pak se 7-10 ditë pune — afat ky që tejkalon gjysmën e afatit total 14-ditor të parashikuar nga AK, duke lënë praktikisht zero kohë për çdo veprim tjetër të detyrueshëm.

Së dyti, projekti realizohet në 4 vendparkime të ndara gjeografikisht, me kapacitete dhe sipërfaqe shumë të ndryshme: Stadiumi Flamurtari (84 poste, 2,460 m²), Shkolla e Marinës (mbi 280 poste — parkingu më i madh), Unaza 2 "Lungomare" (90 poste, 2,600 m²) dhe Fushat e Sportit — Pylli i Sodës (127 poste, 2,890 m²), sipas Relacionit Përshkrimor bashkëlidhur DST-së. Realizimi i punimeve në 4 lokacione të ndryshme, edhe me ekipe paralele, kërkon kohë shume me te madhe se afati i alokuar.

Së treti, realizimi i projektit është i kushtëzuar nga procese administrative me palë/institucione të treta mbi të cilat operatori fitues nuk ka asnjë kontroll. Konkretisht: Sipas Relacionit Teknik Elektrik, çdo pikë parkimi kërkon kontratë të veçantë furnizimi me energji elektrike 5kë monofazë me OSHEE —pra gjithsej 4 kontrata të veçanta. Procedura standarde e OSHEE për inspektim teknik, verifikim disponueshmërie rrjeti, nënshkrim kontrate dhe instalim matësi, sipas praktikës institucionale të njohur, kërkon kohen e vete ligjore, afat ky që tejkalon 14 ditët e parashikuara nga AK, edhe nëse asgjë tjetër nuk do të duhej realizuar. Po sipas Relacionit Teknik Elektrik, instalimi kërkon punime tokëzimi (elektroda Cu 16mm, kabell BC 35mm², gërmime në thellësi minimale 0.60m) dhe Kuadër Elektrik Kryesor (KEK), të cilat janë punime civile që kërkojnë kohë kuruese betoni dhe inspektim teknik para mbulimit. Planimetritë A-07 (Shkolla e Marinës) dhe A-04 (Flamurtari) tregojnë instalimin e spiraleve magnetike (loop detector) me prerje asfalti me trashësi 3-4mm, jo më thellë se 4-5cm dhe me permasa 150×50cm, sipas shënimeve teknike të projektit. Kjo operacion kërkon pajisje të specializuara, kohë tharjeje dhe nuk mund të kryhet paralelisht me lëvizjen normale të makinave në sipërfaqen e parkingut.

Së katërti, konfigurimet dhe testimet e sistemit janë punë teknike intensive që nuk mund të fillojnë pa përfunduar instalimin fizik. Sipas Specifikimeve Teknike, softueri qendror duhet të integrohet me Active Directory, të replikojë të dhëna me të gjitha pajisjet periferike, të konfigurojë tarifat, loopet, barrierat dhe kamerat — dhe të testohet në modalitet offline. Kjo kërkon minimalisht 3-5 ditë pune intensive vetëm për 4 lokacione, pa llogaritur korrigjimin e problemeve.

Së pesti, trajnimet e detyrueshme të parashikuara shprehimisht në Specifikimet Teknike — për stafin e parkimit dhe personelin teknik të Bashkisë Vlorë, me materiale dedikuese në shqip dhe ambient të përshtatshëm — nuk mund të zhvillohen para se sistemi të jetë plotësisht funksional, duke shtuar automatikisht edhe 2-3 ditë shtesë pas komisionimit. Vendosja e afatit 14-ditor, të pamundur teknikisht dhe logjistikisht, prodhon efekte kufizuese të drejtpërdrejta mbi konkurrencën, duke nënkuptuar se vetëm operatorë me infrastrukturë shumë specifike, magazina dhe staf të gatshëm, mund të rrezikojnë nënshkrimin e një kontrate me afat të përealizueshëm ndërkohë që operatorët seriozë dhe ligjërish korrektë, të cilët refuzojnë të angazhohen me afate që nuk mund të respektohen, pengohen de facto nga pjesëmarrja. Kjo bie ndesh me nenin 2, shkronja c dhe ç, dhe nenin 3, pika 2 të LPP Nr. 162/2020, të cilët garantojnë nxitjen e konkurrencës dhe ndalojnë ngushtimin artificial të saj. Vendosja e afatit 14-ditor të përealizueshëm përbën shkelje të dispozitave ligjore.

Autoriteti Kontraktor të rishikojë dhe korrigjojë afatin 14 ditor të realizimit të parashikuar në Shtojcën 6 të DST-së, duke vendosur afate realizimi në përputhje me volumin dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara.

III.4.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK.

Afatet e realizimit të kontratës : 14 ditë

Nr	Përshkrimi i mallit	Njesia	Sasia	Afati Ditor
----	---------------------	--------	-------	-------------

1	Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës e parkimit, me ekran dhe aksesore	Set	4	14 Ditë
2	Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore	Set	4	14 Ditë
3	Pajisje bariere për kontrollin e levizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi parkimit)	Set	8	14 Ditë
4	Pajisje për leximin e biletave	Copë	4	14 Ditë
5	Software qendror për menaxhimin e qendëruar të sistemit të parkimit	Set	4	14 Ditë
6	Pajisje kompjuter për instalimin e programit, monitor	Copë	4	14 Ditë
7	Pajisje kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit	Copë	4	14 Ditë
8	Kamera të jashtme	Copë	33	14 Ditë
9	Kamera e brendshme me audio	Copë	4	14 Ditë
10	DVR me 16 kanale	Copë	2	14 Ditë
11	DVR me 12 kanale	Copë	2	14 Ditë
12	Integrim me shërbim fiskalizimi	Set	4	14 Ditë
13	Letër parkimi, kompatibël me sistemin e parkimit	Rulona	500	14 Ditë
14	Karta RFID	Copë	80	14 Ditë
15	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë
16	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë
17	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë
18	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1	14 Ditë
19	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike e përkulshme 720 mm*705mm (H*W)	Copë	20	14 Ditë
20	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike 1020mm*1105mm (H*W)	Copë	100	14 Ditë
21	Sistem i qendëruar i menaxhimit për raportim dhe analizim	Set	4	14 Ditë

III.4.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, thuhet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor,

social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:- “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret për kualifikim dhe kërkesat për operatorët ekonomikë vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, duhet të vërtetojnë se zotërojnë aftësitë teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses në kohë dhe me cilësi të kontratës në një procedurë prokurimi. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim dhe kërkesat e tenderit gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, në përpjesëtim me natyrën e kontratës së prokurimit.

III.4.4. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, në shtojcën e **Formularit të sasisë së artikujve dhe grafikun e lëvrimit, Afatin e lëvrimit 14 ditë nga nënshkrimi i kontratës, përfshirë furnizimin dhe vendosjen në punë të sistemit.** Pretendimet e operatorit ekonomik janë argumentuar në mënyrë të hollësishme për modifikim të afatit të lëvrimit të mallrave me një analizë të hollësishme bazuar në llojin e procedurës, vlerës, mallrave, vendosjes, punimeve paraprake dhe rëndësisë së çdo kërkesë dhe specifikimi që AK ka këkuar për realizimin e kontratës.

Referuar Proces-Verbalit të argumentimit të kriterëve për kualifikim, Komisioni konstatoi se AK nuk ka argumentuar vendosjen e afatit të lëvrimit të mallrave objekt prokurimi madje me **Vendimin e KSHA-së**, mbi trajtimin e ankesës, gjithashtu nuk ka pranuar, argumentuar se vendosja dhe lënia e afatit 14 ditor të lëvrimit të mallit: **“... lidhet me natyrën e kontratës mallra dhe jo punë...”**.

Komisioni shqyrtoi në tërësi dokumentacionin e procedurës së prokurimit, argumentet e paraqitura nga ankimuesi, si dhe në veçanti analizoi dokumentin “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit”, konkretisht sasi të artikujve të kërkuar, veprime paraprake dhe vendosjen e tyre dhe në referim të testit të proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se afati i lëvrimit të mallrave, në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë dhe në përputhje me volumnin dhe përmasat e kontratës, me qëllim që ofertuesve t’u jepet koha e nevojshme për sigurimin në kohë të mallrave me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi si edhe për vendosjen e tyre sipas projekteve përkatëse.

Përsa argumentuar më sipër Komisioni gjykon që autoriteti kontraktor duhet të modifikojë ndjeshëm afatin e lëvrimit të mallit, në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, përfaqësues të bizneseve të specializuara në procedura të kësaj natyre për realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.5. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të specifikimeve teknike e konkretisht:

Autoriteti Kontraktor në dokumentin Specifikimet Teknike, rubrika Pajisje kompjuter për instalimin e programit, së bashku me monitor, ka kërkuar Kompiuter Brand, me chipset dhe processor Intel, në kundërshtim me nenin 36 të LPP, ku vendosja e togfjalëshit “Ekuivalent” është detyruese në rastat kur përmendet një markë e caktuar prodhimi ose burim specifik apo proces i vecantë që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare.

Kjo kërkesë e AK duke gjykuar nga mënyra se si janë vendosur përbëjnë kufizim për konkurrencën e lirë mes operatorëve ekonomikë.

AK ka vendosur kriter i cili për nga mënyra e vendosjes e kufizojnë konkurrencën, pasi për cdo kriter të vecantë të vendosur, duhet shtuar termi “Ekuivalent”.

Për të konkluduar me këtë pikë, kërkojmë që AK të ndërmarrë masat për përfshirjen e termit “ekuivalent” në Termat e references, Karakteristika teknike Kompiuter Brand, me chipset dhe processor Intel (ose ekuivalent).

AK të ndërmarrë masat për përfshirjen e termit “ekuivalent” në Termat e references, Karakteristika teknike Kompiuter Brand, me chipset dhe processor Intel (ose ekuivalent).

III.5.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Dokumentin Specifikime Teknike për pajisjet objekt ankimi si vijon:

SPECIFIKIME TEKNIKE

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm nr. 584, datë 17.04.2026, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe për përlllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit me objekt ‘Furnizim Vendorsje e Sistemi të Parkimit për “Vlora Parking”, si dhe mbështetur në VKM nr. 358, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, neni 76, Grupi i Punës, u mbledh për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të objektit të prokurimit “Furnizim Vendorsje e Sistemi të Parkimit për “Vlora Parking”,.”.

Grupi i punës specifikimet teknike për zerat e preventivit, i ka marrë nepermjet ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë, si dhe nga një procedure e ngjashme e publikuar në Operatorin e Blerjeve të Përqendruara me linkun si më poshtë:

Pajisje kompjuter për instalimin e programit, së bashku me monitor	
Përshkrim i përgjithshëm	Kompjuter për t’u përdorur për instalimin e software të sistemit të parking.
Karakteristika teknike	Kompjuter Brand, me chipset dhe processor Intel.

III.5.2. Referuar Proces-Verbalit mbi Argumentimin e Kritereve dhe Specifikimeve Teknike AK ka cituar:

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024 **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Në specifikimet teknike, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Në zbatim të nevojave funksionale të institucionit për garantimin e lëvizshmërisë, efikasitetit operacional dhe përmbushjes së detyrave në terren, janë hartuar keto specifikime.

Specifikimet nuk janë kufizuese, janë vendosur në funksion të garantimit të cilësisë, sigurisë në përdorim dhe efikasitet ekonomik dhe operacional duke siguruar konkurrencë të hapur.

Specifikimet teknike janë në përputhje me standartet e tregut dhe nevojat reale të institucionit.

III.5.3. Neni 36/4 “Specifikimet teknike” i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III.5.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenit 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të

gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur dhe gjithpërfshirjen në prokurimin publik.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet, si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu është detyrë e njësive përkatëse të mirëargumentojnë specifikimet teknike që do të prokurojnë, me qëllim që të jenë sa më të plota dhe të sakta, të përcaktojnë parametrat për të dhënë informacion të plotë për artikujt objekt prokurimi.

Në lidhje me përdorimin e termit Ekuivalent, cituar edhe në argumentimin e Specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor duhet të vendosi termin **ekuivalent** tek pajisjet objekt ankimi në përputhje me konstatimet sipërcituar si edhe për faktin se AK ka cituar vendosjen e termit ekuivalent në P-V mbi argumentimin dhe miratimin e Kriteve dhe Specifikimeve Teknike.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit, Specifikimet Teknike, Lista e Zërave artikujve, Relacioni Teknik Elektrik, Preventivi, me argumentet si vijon:

[...] se konstatojmë mungesë të theksuar dokumentacioni çka kërkojmë vëmendje të veçantë përtej një kërkesë për sqarim drejtuar AK. Kjo mungesë vë në pikëpyetje serioze nivelin e përgatitjes profesionale në lidhje me hartimin e termave të Specifikimeve teknike, veçanërisht duke marrë parasysh vlerën që ai përfaqëson.

Shërbimet e këtij niveli kërkojnë një përgatitje teknike të plotë dhe të detajuar, në mënyrë që çdo Operator Ekonomik të ketë mundësinë të kuptojë qartë të gjitha komponentet dhe kërkesat e shërbimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet një llogaritje reale e kostove dhe të sigurohet një konkurrencë e ndershme dhe transparente mes pjesëmarrësve në procedurë. [...] Më poshtë pretendimet më të detajuara;

III.6.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar dokumentet:

Nr	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës së parkimit, me ekran dhe aksesore	Set	4
2	Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore	Set	4
3	Pajisje barierë për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi parkimit)	Set	8
4	Pajisje për leximin e biletave	Copë	4

5	Software qendror për menaxhimin e qendërzuar të sistemit të parkimit	Set	4
6	Pajisje kompjuter për instalimin e programit, monitor	Copë	4
7	Pajisje kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit	Copë	4
8	Kamera të jashtme	Copë	33
9	Kamera e brendshme me audio	Copë	4
10	DVR me 16 kanale	Copë	2
11	DVR me 12 kanale	Cope	2
12	Integrim me shërbim fiskalizimi	Set	4
13	Letër parkimi, kompatibël me sistemin e parkimit	Rulona	500
14	Karta RFID	Copë	80
15	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1
16	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1
17	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi	Set	1
18	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore te tjerë instalativ parkimi	Set	1
19	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike e përkulshme 720 mm *705 mm (H*W)	Copë	20
20	Ndarëse Dekorative Urbane Metalike 1020 mm*1105 mm (H*W)	Copë	100
21	Sistem i qendërzuar i menaxhimit për raportim dhe analizim	Set	4

2. PËRSHKRIMI I SISTEMIT TË PARKIMIT

Secila pikë parkimi publike me pagesë përbëhet nga elementet kryesore elektrike dhe elektronike të mëposhtme, sipas specifikimeve teknike të aprovuara:

Nr	Pajisja	Përshkrim i Shkurtër	Sasia	Fuqia (W)
1	Kolona e hyrjes (Entry Column)	CPU, printer termal biletash, lexues RFID/Barcode, display 7", komunikim RS-485	1 copë	500
2	Kolona e daljes (Exit Column)	CPU, lexues barcode 1D/2D, lexues RFID, display 6.5", komunikim RS-485	1 copë	300
3	Barriera e hyrjes	Motorr elektrik, krah 3m, semafor LED RGB (opsionale), detektor magnetik, 100-240V	1 copë	500
4	Barriera e daljes	Motorr elektrik, krah 3m, semafor LED RGB (opsionale) detektor magnetik, 100-240V	1 copë	500

5	Server Kompjuter + Monitor	CPU Intel, RAM 8GB, 2×256GB SSD RAID1, Windows Server 2016, Monitor 21"	1 set	230
6	DVR 16 kanale	Video regjistruar rrjeti, Smart H.265+, AI, max 10TB HDD	1 copë	55
7	PoE Switch (16 porte)	Çelës rrjeti me furnizim PoE për kamerat, 10/100/1000 Mbps	1 copë	120
8	Kamera të jashtme (IP 5MP)	CMOS 5MP, H.265, IR 30m, PoE, IP67, mikro-SD 256GB	4 copë	60
9	Kamera të brendshme (IP 5MP me audio)	CMOS 5MP, H.265, IR 30m, PoE, IP67, audio	2 copë	30
10	Router / Switch rrjeti	Pajisje rrjeti për komunikimin e sistemit të parkimit dhe raportimit cloud	1 copë	35
11	Skener biletash (USB)	Lexues barcode 1D, 250 skanime/s, lidhje USB 220V	1 copë	20
12	Kioska e Operatorit	1.5×1.5m, ndriçim LED, njësi klimatizimi, priza	1 copë	1 400
13	Ndriçim zona parkimi (LED)	Llampa dhe sistemi i ndriçimit të parkingut dhe hyrjes/daljes (opsionale)	1 set	600
14	UPS (konsumi vetiak)	Konsumi i brendshëm i UPS gjatë ngarkesës (shih seksionin 6)	1 copë	50
TOTALI I FUQISË SË INSTALUAR (P_inst)				4 400 W

Projekti Elektrik	
Përshkrim i përgjithshëm	Kollona e aksesit në hyrje të parkingut të mjeteve motorrike do shërbejë për të kontrolluar aksesin e hyrjes në parking. Për automjetet të cilat kërkojnë tv hynë në parking, kolona duhet të ketë mundësinë e lëshimit të biletës së parkimit nëpërmjet printerit termik të instaluar brenda kollonës. Sapo të tvrhiqet bileta e parkingut nga kolona, duhet të mundesohet hapja e menjëhershme e barrierës së automjeteve. Kollona duhet të jetë funksionale dhe të mundesojë ndërfaqësimin e elementeve të ndryshëm duke ofruar komunikimin dhe ushqimin e ndërfaqeve. Kollona duhet të ketë gjithashtu opsionet: - Lexues RFID - Lexues Barcode 1D/2D - Lexues TAG Kolona duhet të lëshojë biletën apo të lexojë kartën RFID vetëm nëse ka automjet pranë kollonës.
Karakteristika fizike	Të jetë e ndërtuar me material alumini, ose inox të pa ndryshkshëm e të jetë i lyster me bojë në menyrë që të durojë kushtet atmosferike, temperaturat e larta e të ulta, diellin, dhe lagështirën. Të ketë kapak të hapshëm në njerin krah për tv asistuar pajisjet e instaluar në të dhe të mbyllet në menyrë hermetike sipas standardit IP43. Të punojë në temperaturat nga -20 °C deri +40 °C.
CPU dhe	Kollona duhet të ketë një ndërfaqe elektronike inteligjente CPU e cila të

ndërfaqet e komunikimit	shërbejë si menaxher dhe ndërfaqe e pajisjeve që do të montohen në kollonë. Ndërfaqja elektronike duhet të jetë e ndërtuar mbi bazën e një qarku logjik me CPU dhe që funksionon me një sistem operativ si Windows apo Linux. Ndërfaqja, duhet të ketë portë për kartë memorie SD, 2 porta USB dhe 1 Hdmi ku mund të lidhet monitor për konfigurimin dhe shfaqjen e informacioneve ndihmëse për hyrjen me akses. Kollona duhet të ketë një display të paktën 7 inch me ngjyra, i cili do të shërbejë për të shfaqur informacione, ikona dhe mesazhe gjatë procesit të aksesit në parking. Të ketë sensor të matjes së intensitetit të dritës në mënyrë që automatikisht të rrisë ndriçimin e ekranit në rast kohe me diell apo të ulë ndriçimin në rast kohe të vrenjtur apo natën në mënyrë që të optimizohet konsumi i energjisë. Kolona duhet të jetë e ndërtuar me module qarqesh logjike në menyre që të ofroje shtimin e opsioneve në rast nevojë. Ndërfaqet e hyrje-daljeve të kërkuara në kollonë janë: - Portë rrjeti ethernet 10/100 Mbps ; - 3 Porta Hub USB për lidhjen e moduleve me njëra-tjetrën dhe me opsionet e ndryshme që mund të shtohen si printer, skaner biletash, barcode reader etj; - Ndërfaqe MicroUSB; - Ndërfaqe display LVDS për të lidhur ekranin e kollonës; - Portë HDMI; - Ndërfaqe SD Card; - Ndërfaqe për të lidhur një kamera opsionale; - Ndërfaqe për të instaluar opsionin e touch screen; - Altoparlant; - Ndërfaqe komunikimi me Barrieren në formë seriale RS-485Celes për komandim manual të barrierës. Kolona, duhet të jetë e pajisur me printer termal për printimin e biletave të parkimit. Printeri mund të përdorë letër në formë rruli ose fanfold. Skedat duhet të kenë drita sinjalizuese për të shfaqur gjendjen e komunikimit dhe në rast problemesh teknike të ndihmojë në evidentimin e problemeve.
Ushqimi dhe karakteristika ambientale	Tensioni i ushqimit të kollonës 100-240 V, Max 5A Ushqimi i pajisjeve në barrierë të jetë me tension të ulët 12/24 V DC. Temperatura e punës -20 °C deri ne +40 °C, Lagështia 90%. Shkalla e mbrojtjes nga faktoret ambientalë IP43.
Aksesorë	Kollonat duhet të jenë të qëndrueshme dhe duhet të montohen në terren duke betonuar më pare një element mbajtës i cili duhet të funksionojë si bazament i kollonës. Kollona duhet të ketë mundësi të montohet e çmontohet lehtësisht nga bazamenti. Për dedektimin e prezencës së automjetit dhe drejtimit të lëvizjes në korsi, duhet të instalohen në tokë të paktën 2 spira magnetike për çdo korsi.

<i>Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesorë</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Kollona e aksesit në dalje të parking të mjeteve motorrike do shërbejë për të lexuar biletën e marrë në hyrje në parking pasi është bërë pagesa ose për leximin e kartës RFID. Në këtë rast, nëse pagesa është kryer, drejtuesi i mjetit, afrohet pranë kollonës në dalje në të cilën lexon biletën dhe hap traun në dalje. Kollona duhet të jetë funksionale dhe të mundësojë ndërfaqësimin e elementeve të ndryshëm duke ofruar komunikimin dhe ushqimin e ndërfaqeve.

	Kollona duhet të ketë opsionet: - Lexues RFID - Lexues Barcode 1D/2D - Lexues TAG Kolona duhet të lexojë biletën, kartën RFID vetëm nëse ka automjet pranë kollonës. Për këtë duhet instaluar sensor/spire magnetike në prani të kollonës, i cili aktivizon kollonën dhe i jep mundësinë të lexohet bileta. Në mungesë të pranisë së makinës, kolona duhet të jetë në gjendje pritje (stand by) duke ulur ndriçimin për të kursyer energji. Drejtuesi i automjetit, duhet të lexojë biletën në lexuesin barcode të instaluar në kollonë i cili ndriçohet me prezencën e automjetit.
Karakteristika fizike	Kollona duhet të jetë e ndërtuar për këtë qëllim me permasa të pershtatshme në mënyrë që të mundësojë shoferin të lexojë biletën apo kartën e aksesit pa zbritur nga makina. Te jete e ndertuar me material alumini, ose inox të pa ndryshkshem e te jete i lyer me boje në mënyrë që të durojë kushtet atmosferike, temperaturat e larta e të ulta, diellin, dhe lageshtirën. Te ketë kapak të hapshëm në njërën krah për të asistuar pajisjet e instaluar në të dhe të mbyllet në mënyrë hermetike sipas standardit IP43. Te punojë në temperaturat nga -20°C deri $+40^{\circ}\text{C}$.
CPU dhe ndërfaqet e komunikimit	Kollona duhet të ketë një ndërfaqe elektronike inteligjente CPU e cila të shërbejë si menaxher dhe ndërfaqe e pajisjeve që do të montohen në kollonë. Nderfaqja elektronike duhet të jete e ndertuar mbi bazën e një qarku logjik me CPU dhe që funksionon me një sistem operativ si Windows apo Linux. Nderfaqja, duhet të ketë porte për kartë memorie SD, 2 porta USB dhe 1 HDMI ku mund të lidhet monitor për konfigurimin dhe shfaqjen e informacioneve ndihmëse për hyrjen me akses. Kollona duhet të ketë një display me përmasa dhe rezolucion të përshtatshëm, për të shfaqur informacione, ikona dhe mesazhe gjatë procesit të aksesit në parking. Te ketë sensor të matjes së intensitetit të dritës në mënyrë që automatikisht të rrisë ndriçimin e ekranit në rast kohe me diell apo të ulë ndriçimin në rast kohe të vrenjtur apo natën në mënyrë që të optimizohet konsumi i energjisë. Kolona duhet të jete e ndertuar me module qarqesh logjike në mënyrë që të ofrojë shtimin e opsioneve në rast nevojë. Nderfaqet e hyrje-daljeve të kërkuara në kollonë janë : - Portë rrjeti ethernet 10/100 Mbps - 3 Porta Hub USB për lidhjen e moduleve me njëra tjetrën dhe me opsionet e ndryshme që mund të shtohen si printer, skaner biletash, barcode reader etj. - Nderfaqe MicroUSB - Nderfaqe display LVDS për të lidhur ekranin e kollonës - Portë HDMI - Nderfaqe SD Card - Nderfaqe për të lidhur një kamerë opsionale - Nderfaqe për të instaluar opsionin e touch screen. - Altoparlant - Nderfaqe komunikimi me Barrierën në formë seriale RS-485 dhe komandë - Çelës për komandim manual të barrierës Në kollonë duhet të jete instaluar lexuesi barcode i biletave : Duhet të lexojë formatin barcode 1D/2D të biletave të leshuara, si dhe të

	biletave apo kuponave te paraprintuar. Skedat duhet te jene drita sinjalizuese per te shfaqur gjendjen e komunikimit dhe ne rast problemesh teknike te ndihmoje ne evidentimin e problemeve.
Ushqimi dhe karakteristika ambjentale	Tensioni i ushqimit te kollones 100-240 V, Max 5A Ushqimi i pajisjeve ne barriere te jete me tension te ulet 12/24 V DC. Temperatura e punes -20 °C deri ne +40 °C, Lageshtia 90%. Shkalla e mbrojtjes nga faktoret ambjentale IP43.
Aksesorë	Kollonat duhet te jene te qendrueshme dhe duhet te montohen ne terren duke betonuar me pare nje element mbajtes i cili duhet te funksionoj si bazament i kollones. Kollona duhet te kete mundesi te montohet e zmontohet lehtesisht nga bazamenti. Per dedektimin e prezences se automjetit dhe drejtimit te levizjes ne korsi , duhet te instalohen ne toke te pakten 2 spira magnetike per cdo kollone. Duhet te parashikohen te gjitha aksesoret per instalimin e ketyre loop.

<i>Pajisje barriere për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi i parkimit)</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Per te administruar aksesin e makinave, kerkohet te instalohen edhe barriera automjetesh. Barriera te jete prodhuar nga i njejt prodhues i kollonave dhe sistemit te aksesit si dhe te kete nderfaqe komunikimi data me kollonen ne menyre qe sistemi softëare te komunikoje e menaxhoje barrieren. Kjo barriere duhet te kete mundesine per te instaluar ne trupin e saj, ne lartesine e traupit, nje semafor LED, RGB i cili do te sherbeje per te njoftuar perdoruesit e parkimit te cilet kerkojne te hyjne ne parking.
Karakteristika teknike e fizike	Tensioni i punes: 100-240 V ±10% / 50-60 Hz / rreth 500 W Temperatura e punes: -20 °C to 50 °C Trupi i barrieres, te jete i ndertuar me materiale te forta e te pa-ndryshkshme. Te kete mbrojtje ambjentale me standard IP44. Barriera te kete mundesi te hapet e mbyllet me shpejtesi dhe kjo shpejtesi te jete e konfigurueshme nga software i sistemit te parking. Barriera duhet te kete opsionin e shtimit te nje semafor te instaluar ne trupin e barrieres, me led me 3 ngjyra RGB, e cila duke u ndricuar me ngjyra te ndryshme dhe te konfigurueshme, informon drejtuesin e mjetit ne menyre inteligjente mbi kalimin ne barriere. Keto opsione te jene te personalizueshme nga software i sistemit te parking. Trau i barrieres te jete i ndertuar me material te lehte por durues i kushteve atmosferike si dhe ne rast goditje me automjetin, te rrezohet ne toke per te mos demtuar automjetin. Krah i barrieres te kete gjatesine 3m. Krah i barrieres te mund te komandohet nga nje elektromotorr dhe te mos jete i ndertuar me pajisje hidraulike te cilat kane nevojte per asistence. Te jete pajisje e qendrueshme dhe koha e llogaritur ndermjet mirmbajtjeve (e deklaruar nga prodhuesi ne katalog) te jete rreth 2 milion cikle. Krah i barrieres duhet te jete me materiale te lehta e te forta ne menyre qe te lehtesohe hapjen e krahut. Krah i barrieres te kete mundesi te vendosjes se ndricimit te krahut per tu dalluar me qarte naten. Te kete nje bord/nderfaqje inteligjente e cila te komunikoje ne menyre seriale: RS485 me kollonen e hyrjes apo daljes duke njoftuar mbi statusin e korsise. Te kete te instaluar 1 dedektor magnetik automjetesh me 2 kanale i cili te lidhet me spirat magnetike te montuara ne toke. Poshte krahut te barrieres duhet instaluar nje spire e konfiguruar ne nje nga kanalet e dedektorit, per te

	parandaluar mbylljen e barrieres ne momentin qe kalon automjeti. Gjithashtu kjo do te njoftoje sistemin e parkimit mbi hyrje-daljet nga secila porte. Ne kanal in tjeter te dedektorit duhet te instalohet spira tjeter e prezences ne kollone e cila njofton sistemin per prezencen e automjetit dhe aktivizon funksionet e kollones.
Karakteristika funksionale	Barriera te kete logjike inteligjente me te cilen duke komunikuar me elementet e tjere si kollona, loop detector, etj, Te kete mundesine e konfigurimit nga softëare ne rrjet, monitorimit te gjendjes se barrieres, update te software/firmware te barrierës, testim ne distance, etj. Shpejtësia e hapjes se barrieres te jete e konfigurueshme nga software i sistemit te parking. Te kete dedektor te demtimit apo mungeses se traut. Barriera duhet te komunikojë ne kohe reale me software e sistemit te parking, duke treguar statusin e saj, si psh Hapur, Mbyllur, offline, etj, si dhe te mund te meren informacione mbi problematiken e barrieres ne kohe reale.
Opsione shtesë	Barriera te kete mundesi shtese te mevonshme ne rast nevojë te: - Te kete aftesi te mbaje krah te gjate deri ne 4,5m. - Te kete mundesi opsionale te montimit ne nje moment te dyte te nje krahut te ndriçuar me drita RGB, te cilat ndizen me ngjyra te ndryshme sipas levizjes se krahut te barrieres. Ky opsion duhet te jete i konfigurueshem nga softëare. - Ndricim i konturuar me LED perreth barrieres per te dalluar me qarte barrieren naten. - Mundesi instalimi i nje kamere ne trupin e barrieres. - Mundesi instalimi te lexuesve TAG direkt ne barriere.

<i>Pajisje për leximin e biletave</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Skaneri i leximit te biletave do te perdoret per te lexuar biletat me barcode te lëshuara nga sistemi. Pas leximit, skaneri barcode i dergon softëare te menaxhimit te Parking numrin e biletës per te percaktuar vleren e pageses.
Skaner biletash	Skanimi të barkodeve me 1 linjë Shpejtësia e skanimit: 250 skanime në sekondë. Këndi i leximit, deri ne 65 gradë.
Ndërfaqe	Pajisja te lidhet me kompiuterin e operatorit me porte USB.
Kushtet e punës	Ushqimi të jetë 220V. Temperatura e punës nga 0 °C deri në +40 °C.

<i>Software qendror për menaxhimin e qendëruar të sistemit të parkimit</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Me programin për administrimin të parkimit, do të kuptohet tërësia e moduleve software të cilat shërbejnë për menaxhimin e sistemit të aksesit dhe parkimit. Ky software duhet të jetë i ndërtuar me module software të cilat mund të instalohen në hardware të veçantë për të shpërndarë ngarkesën në rast nevojë. Të gjitha modulet e kërkuara duhet të shoqërohen me licencat përkatëse. Modulet dhe zërat opsionale të jenë të mundshme të shtohen me kërkesën e kontraktorit në rast nevojë.
Karakteristika funksionale	Duhet të ketë disa nga funksionet kryesore te Software të Sistemit të Parkimit: - Modulin e konfigurimit te sistemit - Modulin e konfigurimit te perdoruesve - Modulin e arketimit dhe prodhimit te lejeve te parking

	Software qendror duhet te instalohet ne sistem Windows Server, ne menyre qe te konfigurohet Active Directory e dedikuar per kete softëare. Integrimi me AD, do te mundesoje sinkronizimin e te gjitha kollonave te hyrje daljes, pajisjeve dhe kompiuterave ne te njejten kohe, perforcimin e sigurise dhe administrimin e komunikimit ne rrjet ne menyre te centralizuar. Kollonat duhet te kene sistem operativ (Windows ose Linux) ne menyre qe te jene pjese e ketij domain AD. Kjo do te duhet per funksionin e sinkronizimit te ores, perdoruesve, passëord dhe te drejtave ne menyre te qenderzuar. Softëare duhet te jete ndertuar per te permbushur nivelin e sigurise te procesimit te kartave te kredidit sipas kriterave nderkombetare PCI/PA-DSS. Sistemi i Parking duhet te funksionojë normalisht edhe ne rast se per nje interval kohe jo te gjate, Software ose server nuk mund te komunikojne me pajisjet e parking (offline). Kjo do te thote qe softëare qendror duhet te replikojë te dhenat me pajisjet periferike duke bere qe keto te fundit te perdorin inteligjencen dhe te dhenat lokale ne modalitet offline.
Arkitektura e sistemit	Sistemi software i menaxhimit te parking te makinave duhet te jete i ndertuar bazuar ne arkitekturen klient-server. Software duhet te kete nderfaqet e konfigurimit te sistemit te cilat duhet te aksesohen vetem nga perdoruesit administratore te cilat kane te drejta ekskluzive mbi konfigurimet ne sistem. Gjithashtu duhet te kete edhe nderfaqet klient te operatoreve te cilet duhet te kene te drejta te kufizuara ne konfigurimin e sistemit dhe te drejta sipas niveleve te percaktuara ne nderfaqet e operimit, kontrollit dhe administrimit financiar te sistemit. Komunikimi ne rrjet dhe ndermjet moduleve te jete i enkriptuar. Te dhenat e sistemit duhet te ruhen ne nje databaze DBMS e cila te jete fleksibel, dhe e sigurte. Vete databaza duhet te jete e enkriptuar ne menyre qe te siguroje kofidencialitetin dhe sigurine e te dhenave ne sistem.
Moduli i konfigurimit dhe administrimit të sistemit	Ky modul software do te sherbeje per te konfiguruar te gjitha opsionet e sistemit te aksesit. Funksionet kryesore te te modudit te konfigurimit : - Te konfiguroje sistemin ne teresi, zonat e aksesit dhe ato te parkimit, te dhenat mbi monedhen e perdorur, zonen kohore, te dhena mbi operatorin etj. - Të konfigurojë në sistem të gjitha nyjet hardware si Kollonat, lexuesit, Pajisjet PDA, Pajisjet e prodhimit te biletave dhe kartave si dhe te gjitha pajisjet e tjera ndihmese te sistemit te aksesit. - Te kete funksionin e dedektimit automatik te pajisjeve te lidhura ne sistem nepermjet skanimit te rrjetit Ip . - Te kete funksionin e administrimit te artikujve te aksesit, biletave, kartave, Tag UHF etj ... Cdo artikull mund te personalizohet sipas kerkesave te kontraktorit duke mundesuar shumllojshmeri artikujsh dhe menytrash aksesimi per persona te ndryshem. - Regjistrimi i perdoruesve te sistemit te aksesit si dhe caktimi i personalizuar i aksesit afatgjate nepermjet kartave, tag UHF etj. - Vendosja e tarifave per cdo artikull dhe aplikimi i tarifave sipas politikave te percaktuara nga Kontraktori ne baze te intervaleve kohore, diteve javore, festave etj. - Konfigurimi i kohes se aksesit afatgjate per perdoruesit me kontrate ne menyre te personalizuar per cdo perdorues (Opsionale:nese do te perdoren perdorues me kontrate paraprake dhe akses ne parking me karte RFID, TAG, Akses Barcode etj.). - Te kete mundesi e ruajtjes te te dhenave te rendesishme per personat te cilet do te administrohen ne sistemin e kontrollit te aksesit si : - o Emri, Mbiemri, Kompania, ID, Adresa etj.

	- Konfigurimi dhe administrimi i stafit dhe perdoruesve te software. Cdo perdorues i software duhet te autentikohet ne sistem duke vendosur emrin e perdoruesit dhe fjalekalimin e tij. Çdo perdorues mund te personalizohet ne nivelet e aksesit ne softëare sipas nevojave dhe detyres. - Të mund të aktivizohen licencat e sistemit. - Të mund të krijohet një axhendë për kryerjen e backup automatik dhe arkivimin e të dhënave - Të mund të konfigurohet numurimi i mjeteve. - Të ketë një ndërfaqe të konfigurimit të Validimit te aksesit i cili ka qëllim krijimin e biletave apo kartave të personalizuar të cilat kanë si funksion dhënien e mundësisë të vlerësimit të një bilete sipas mundësive të mëposhtme: - o Specifikimi i nje intervali tarife parkimi apo qëndrimi minimal dhe maksimal - o Intervali kohë për përdorimin e validimit - o Lejimi apo jo i një pike validimi - o Aplikimi i tarifave skonto me përqindje mbi një tarifë të caktuar, etj. Ndërfaqja e Validimit do të mund të përdoret nga operatori për të mundësuar parking falas ose me vlerë të zbritur për automjete të përzgjedhura sipas kërkesës së kontraktorit.
Moduli i pagesave dhe i lëshimit të biletave	Ky modul software ka si qëllim kryesor funksionimin si nyje për leximin e biletave, shfaqjes së vlerës si dhe arkëtimin e pagesave sipas tarifave të përcaktuara nga moduli i konfigurimit. Funksionet e kërkuara të kesaj ndërfaqe: - Lëshimin e biletave të aksesit ditore/afatshkurtra - Lëshimin e biletave të parkimit me kohë (pas pagesës ose para pagesës) - Lëshimi i kartave Rfid/Tag për kontratat afatgjata - Procesim të transaksionit monetar (arkëtimi) - Anullim te transaksionit - Kryerja e pagesave hyrese dhe dalese te arkes - Modifikimi i diferencave te pagesave cash - Mbyllja e hapja e turneve ku cdo operator ka perdoruesin e tij ne sistem te mbrojtur me passëord - Kombinimi i kombinimit te pagesave me menyra te ndryshme psh Cash + Çek - Leximi i të dhënave të një karte Rfid apo bilete barcode.Etj Funksioni i prodhimit te biletave do te aktivizohet nese do te jete e nevojshme ne forme opsionale duke shtuar nje printer biletash ne sistem. Funksione opsionale të aktivizueshme me ane të licencave shtesë në rast nevojë: - Funksioni opsional i përlllogaritjes së tarifës së pagesës. - Funksioni i vlerësimit nëpërmjet të cilit, duke lexuar një kupon skonto ose një biletë, mund te ofrohen skonto, tarifime të personalizuar etj. - Caktimi i biletave apo artikujve te tjere te aksesit per nje ngjarje (event) të caktuar, psh. Karta vizitori, bileta afatgjata, bileta eventit etj. - Riprodhimi i nje bilete te te humbur duke vendosur targon e mjetit - Procesimi i pagesave me karte krediti - Lëshimi i rimbursimit tek karta e kreditit - Regjistrimi manual i nje karte krediti me te dhenat e saj - Lëshimi i një e-Bilete (e-ticket) - Leximi i voucher opsionale - Gjenerimi i një bilete tjetër zëvendësuese në rast bilete të dëmtuar duke vendosur numrin e biletës Ndërfaqja e software të jetë e optimizuar për t'u përdorur me ekranet me prekje

	(touch screen).
Moduli i kontrollit	Në këtë ndërfaqe, përdoruesi do të mund të monitorojë e kontrollojë të gjitha pajisjet e sistemit të aksesit. Çdo pajisje e sistemit të aksesit si kollonat, lexuesit, Pda (opsionale), терминаlet e operatorit, do të mund të shfaqen në këtë ndërfaqe në menyrë të dallueshme me ikonën përfaqësuese për secilin model dhe për secilen portë apo korsi aksesit. Çdo pajisje duhet të shfaqë në kohe reale nëse ka ndonjë problem komunikimi apo problem tjetër funksional. Ikona e pajisjes, duhet të ndryshojë duke paraqitur në formë grafike gjendjen e sistemit. Operatori, mund të përzgjedhë pajisjen dhe të ekzekutojë komanda mbi të si: - Komandë për hapjen manuale të barrieres apo turnstile - Komandë për bllokimin / aktivizimin e një porte këmbësorësh apo korsie automjetesh - Komandë për res-et e anti-passback - Komandë e funksionit opsional të komunikimit me citofon me pajisjet e aksesit. - Verifikimi i vendeve të lira për një zonë parkimi të caktuar. - Çaktimi i numurimit të makinave - Në kollonat hyrese: e dalese - o Verifikimi i status - o Hapje manuale të barrieres, lenie hapur të barrieres - o Mbajtje e mbyllur e barrieres - o Aktivizimi/çaktivizimi i pajisjeve Gjithashtu kjo ndërfaqe duhet të shfaqë të dhëna log mbi ngjarjet e sistemit, mesazhet mbi gjendjen e sistemit si dhe mbi hyrje-daljet në zonat e sistemit të aksesit.
Ndërfaqja e raportimit	Në këtë ndërfaqe të ketë një funksion për nxjerrjen e detajuar të raporteve ditore, mujore apo periudhave të caktuara sipas nevojës. Këto raporte duhet të japin informacion mbi aksesin në sistem sipas çdo porte dhe të ketë mënyra filtrimi sipas kushteve të ndryshme. Software duhet të shfaqë raportet e sistemit si: • Raportet ditore • Raportet mujore • Raportet filtruara • Raportet e turneve • Raportet e përdorimit të voucher • Raportet e biletave të kthyer • Raportet e fluksit të biletave • Raportet e fluksit të parave • Raportet e pagesave të vonuara • Raporte të personalizueshme Përveç raporteve, sistemi duhet të mundësojë aktivizimin e log të detajuar me nivele të përzgjedhura për zgjidhjen e problemeve të sistemit. Logët duhet të kenë mundësi të përzgjedhjen për çdo pajisje duke regjistruar çdo detaj të transaksioneve dhe komunikimit me pajisjet.

<i>Pajisje kompjuter për instalimin e programit, së bashku me monitor</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Kompjuter për t'u përdorur për instalimin e software të sistemit të parking.
Karakteristika teknike	Kompiuter Brand, me chipset dhe processor Intel
Pikët min. për procesorin	6500

sipas: cpu benchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:	
“RAM”:	8 GB, min. DDR3 1600 MHz
Hard Disk “HDD Size”:	2 x 256 GB SSD te konfiguruar minimalisht ne RAID1
“Media Device”:	DVD+/-RW
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e komunikimit :	Min. (6) porta USB, (1) RJ-45, (1) audio in/out, (1) mic. and headphone, (1) VGA.
Rrjeti :	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port.
Zeri :	Integrated Sound Card
Mikrofone :	Internal or Built-in Monitor
Sistemi i Operimit :	windows server 2016 Server x64
Tastiera :	QWERTY
Mouse :	Minimum 2 Button scroll Optical
Ushqimi :	220 V AC, 50 Hz
Monitor	- Dimensioni i ekranit, min 21” . - Rezolucion min 1600 x 900 - Kontrast 600:1 / 10000000:1 dinamik - Ndricimi 200 cd/m² - DisplayPort ose HDMI, ose VGA

<i>Pajisje Kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Sistemi i Parking do të duhet të pajiset me kioske ku do të qëndrojnë operatori që do të merret me vjeljen e të ardhurave.
Karakteristika	Kioska duhet të jetë material rezistent. Përmasat e kioskes duhet të jenë minimalisht 1.5m x 1.5m, te pershtatshme për të mbajtur një post pune bashkë me pajisjet përkatëse. Kioska duhet të jetë e pajisur me derë si edhe me dritare që të shërbejë si pjesë e hapur për arkëtimin e pagesave nga operatori.

<i>Letër parkimi, kompatibel me sistemin e parkimit</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Letër printeri e përshtatshme për përdorim nga sistemi i parkimit.
Karakteristika	Materiali letër e bardhë e printueshme. Teknologjia e printimit: termike. Sipërfaqe rezistente ndaj gërrvishtjeve. Të mund të printohet në të gjithë sipërfaqen. Kushtet ambientale –20 °C deri në +40 °C

<i>Karta RFID</i>	
Përshkrim i përgjithshëm	Karta aksesi RFID.
Karakteristika	Karta plastike për përdorim jetëgjatë.

	Të duroj temperaturë deri nga -30°C deri me +50°C. Kartë me frekuencë pune 13.56 Mhz ISO 14443 (ose ekuivalente) Karta duhet të ofrojë siguri të lartë, njëjtë si në kartat e kreditit. Kartat duhet të lejojnë disa lloje lejesh te ndryshme. Kartat duhet të jenë kompatibël me sistemin e parkimit.
--	---

Raportim i Qendërzuar	
Përshkrimi i përgjithshëm:	Raportim i qendërzuar , i aksesueshem kudo per mbledhjen dhe kontrollit te sistemit te parkimit.
Karakteristika teknike e fizike:	Suport për motorrat e kërkimit standard (Google Chrome, Mozilla Firefox, Safari, Edge) Integrim i plotë me sistemin aktual të parkimit. Lidhje në internet Periodha e ruajtës të të dhënave: 8 muaj. Sistem i hostuar ne Cloud
Karakteristika funksionale:	Numër i gjerë raportesh tabelash. Funksione të ndryshme filtrimi për raport. Dërgimi i raporteve në formate të ndryshme të të dhënave (PDF, Excel, CSV) me email - manualisht ose automatikisht (planifikim). Eksport i shpejtë i të dhënave në formate të ndryshme të të dhënave (PDF, Excel, CSV) Printim i raporteve Menaxhimi i përdoruesit dhe roleve Funksion kërkimi për raportet Strukturim i qartë i raporteve në kategori të tilla si financa, hyrje/dalje ose monitorim. Aplikacion i lehtë për t'u përdorur ne ëeb Te jete i integruar plotesisht me sistemin e parkimit Krahasim periudhash sipas muajve, diteve te javesh fundjavave etj gje qe do te sherbeje per marrje vendimesh mbi oraret e pikut etj.

Kamera të jashtme	
Përshkrimi i përgjithshëm:	Kamera survejimi me rezolucion minimal 4mp dhe lente minimumi 2.8 deri në 3.6mm, mundësi shikushmërie për natën të paktën infrared ose me ngjyra. Rezizstente ndaj kushteve atmosferike, pluhurave, lageshtirës.
Karakteristika funksionale dhe teknike:	Sensor imazhi CMOS 1/2.7" • 5MP (2592 × 1944) @20 fps, dhe me 2688 × 1520 (2688 × 1520) @25/30 fps • Kompresimi videos H.265 • LED IR i integruar, distanca maksimale IR: 30 m • ROI, SMART H.264+/H.265+, kodim fleksibël, i zbatueshëm për mjedise të ndryshme bandwidth dhe ruajtjeje • Modaliteti WDR, HLC, BLC • Zbulim anomalish: Zbulim lëvizjeje, ndërhyrje video, pa kartë SD, karta SD plot, gabim i kartës SD, rrjet i shpëputur, konflikt IP, akses i paligjshëm

	• Mundesi për integrim 256 GB kartë Micro SD • Furnizim me energji 12V DC/PoE • Mbrojtje IP67
--	---

Kamera e brendshme me audio	
Përshkrimi i përgjithshëm:	Kamera survejimi me rezulucion minimal 4mp dhe lente minimumi 2.8, mundesi shikushmerie per naten te pakten infrared ose me ngjyra.
Karakteristika funksionale dhe teknike:	Sensor imazhi CMOS 1/2.7" • 5MP (2592 × 1944) @20 fps, dhe me 2688 × 1520 (2688 × 1520) @25/30 fps • Kompresimi videos H.265 • LED IR i integruar, distanca maksimale IR: 30 m • ROI, SMART H.264+/H.265+, kodim fleksibël, i zbatueshëm për mjedise të ndryshme bandwidth dhe ruajtjeje • Modaliteti WDR, HLC, BLC • Zbulim anomalish: Zbulim lëvizjeje, ndërhyrje video, pa kartë SD, karta SD plot, gabim i kartës SD, rrjet i shkëputur, konflikt IP, akses i paligjshëm • Mundesi për integrim 256 GB kartë Micro SD • Furnizim me energji 12V DC/PoE • Mbrojtje IP67

DVR me 16 kanale	
Përshkrimi i përgjithshëm:	Video regjistrator imazhi për kamerat e survejimit me 16 kanale. Mundësi për të instaluar 2HDD me kapacitet maksimal deri në 10TB Me AI për video regjistrator rrjeti.
Karakteristika funksionale dhe teknike:	• Formati i dekodimit Smart H.265+/H.265/Smart H.264+/H.264/MJPEG. • Ruajtje imazhi me 256 Mbps (180 Mbps kur funksioni i AI është i aktivizuar). • Aftësia maksimale e dekodimit: 16 × 1080p@30 fps. Me dekodimin adaptiv. • AI nga NVR: Zbulim dhe njohje e fytyrës me 1 kanal; mbrojtje e perimetrit me 2 kanale; SMD Plus me 4 kanale. • AI nga kamera: Zbulim dhe njohje e fytyrës, mbrojtje e perimetrit; SMD Plus; ANPR; numërim i njerëzve; analizë stereo; hartë nxehtësie.

Integrim me shërbimin e fiskalizimit	
Përshkrimi i përgjithshëm:	Sistemi i parkimit duhet të komunikojë në kohe reale me program për fiskalizimin e faturës tatimore.
Karakteristika funksionale dhe teknike:	Integrimi duhet të mundësojë që në momentin e arkëtimit të parave nga ana e operatorit, informacioni mbi pagesën të shkojë në kohë reale në programin e fiskalizimit dhe nga programi i fiskalizimit të printohet fatura fiskale.

III.6.2. Në lidhje me pretendimet e Operatorit Ekonomik mbi dokumentet sipërcituar me argumente si vijon:

Shtojca 2 Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit ka cituar .

SISTEMI PARKIMIT NË SHESHE (lekë)					
Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi	Total pa Tvsh
1	Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës e parkimit, me ekran dhe aksesore	Set	4		
2	Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore	Set	4		
3	Pajisje bariere për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi parkimit)	Set	8		
4	Pajisje për leximin e biletave	Copë	4		
5	Software qendror për menaxhimin e qendëruar të sistemit të parkimit	Set	4		
6	Pajisje kompjuter për instalimin e programit, monitor	Copë	4		
7	Pajisje kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit	Copë	4		

Dhe tek dokumenti Projekti _Parkimeve, ka cituar dhe përcaktuar se do jenë:

4 set parkime dhe konkretisht:

1. Parkimi tek Stadiumi Flamurtari, ku nga projekti janë parashikuar një sistem parkimi me 84+8 poste parkimi.
2. PARKIMI NË UNAZËN 2 LUNGOMARE ku nga projekti janë parashikuar një sistem parkimi me 88+2 poste parkimi.
3. PARKIMI TE FUSHAT E SPORTIT NË PYLLIN E SODËS ku nga projekti janë parashikuar një sistem parkimi me 125+2 poste parkimi.
4. PARKIMI TE SHKOLLA E MARINËS, ku nga projekti nuk jepen detaje mbi sasinë e posteve të parkimit si dhe nga ana tjetër vërehet në projekt se janë dizenuar 2(dy) sisteme parkimi. Dallohet qartë që kemi 2 Hyrje dhe 2 dalje parkimi. Pra në total nuk kemi një set pajisjesh por 2 sete pajisjesh.

AK NUK KA TE QARTË SE SA SISTEME DO.

Kërkesa: Të saktësohet që do të jenë 2(dy) sisteme parkimi apo 1(një) sistem parkimi.

Kërkesa: Të saktësohet dhe planvendosja e zërave 19 dhe 20.

Kërkesa: Në lidhje me art 8 dhe 9 Kamera të Jashtme dhe të Brendshme.

a) Cila është mënyra e shpërnadarjes (sasisë) së kamerave në 4(katër) objektet e përcaktuara?

b) Nuk jepen të dhëna mbi mënyrën e vendosjes së tyre me saktë shtylla apo struktura të tjera?

Kërkesa; "A do të kryhen punime civile (qërmime, betonim bazamentesh) për vendosjen e shtyllave, dhe nëse po, a janë këto punime pjesë e kontratës apo jashtë saj?

Cili është autoriteti përgjegjës?"

c) "A parashikohet infrastrukturë e kabujve nëntokësorë (tuba mbrojtëse, tunel kablor) apo zgjidhje ajrore? A është furnizimi me kabuj UTP/FTP dhe kablot e energjisë pjesë e kësaj kontrate?"

d) **Ka nje plan implementimi apo projekt** i cili te permbaje informacionin e nevojshem dhe cdo teknikalitet tjeter ne funksion te zbatimit?

A ekziston një projekt elektrik/teknik i miratuar nga autoritetet kompetente që do t'i vihet në dispozicion ofertuesit fitues para fillimit të punimeve?

Kërkesa: Gjithashtu Autoriteti Kontraktor te percaktoje nese do te jete OE përgjegjes per sigurimin e lejeve/autorizimeve te nevojshme per punimet civile, verifikimet nga OSHEE etj, ne fuksion te realizimit te ketij projekti.

Në këtë dokument janë cituar edhe zëra si

4- Detektor magnetik- Numri i kanaleve i pa përcaktuar. Specifikimet teknike të barrierës tregojnë se detektori magnetik duhet të jetë "me 2 kanale" (një për spirën nën krah, një për spirën e prezencës). Megjithatë, në disa seksione referenca është vetëm "detektor magnetik" pa specifikuar kanalet. **Kjo paqartësi ndikon drejtpërdrejt mbi koston e pajisjes dhe kompatibilitetin e sistemit. Te specifikohen kanalet.**

7- PoE Switch (16 porte).

13-Ndriçim zona parkimi (LED)

14-UPS (konsumi vetiak).

Keta artikuj nuk janë parashikuar si zëra në LISTA E CMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT, sipas shtojcës 2 të DST.

Kërkesa • Do jetë përgjegjësi e operatorit ekonomik të kontraktuar furnizimi i tyre?

Nëse po, nevojitet te ndermerren masat e nevojshme per pasqyrimin e ketyre zerave ne Shtojca 2, Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit

- Shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK-së

- Shtojca 10, Preventivi

Sistemi qendror, në cilën pajisje infrastrukture, a disponon Institucioni kapacitetet e nevojshme hostuese?

Nëse po, cfarë kapacitetesh mund të vendosë në dispozicion të sistemit të qendëruar të parkimit?

Për zërin Software qendror per menaxhimin e qenderzuar te sistemit te parkimit AK kërkon: Të gjitha modulet e kerkuara duhet te shoqerohen me licencat perkatese **Si duhet të jëtë licenca e zgjidhjes së propozuar, e përhershme/lifetime apo me abonim/subscription?** Nese eshte me license, sa eshte periudha e kerkuar e licensimit?

Lidhur me zërin Raportim i Qenderzuar, AK ka kërkuar Sistem i hostuar ne Cloud Lidhur me këtë kërkesë ka paqartësi, për cfarë periudhe të ofrimit të këtij shërbimi është përgjegjës operatori ekonomik ofertues duke qenë se zgjidhja kërkohet e hostuar në cloud.

Cila eshte periudha e kerkuar e hostimit? AK nuk ka dhënë asnjë informacion nëse disponon infrastrukturë hostuese vetjake dhe nëse mund ta vendosë në dispozicion të ofertuesit fitues si alternativë

Pretendime mbi piken 7.2 Rekomandime Teknike

- Para fillimit të punimeve, të verifikohet disponueshmëria e rrjetit elektrik 230V OSHEE afër secilës pikë parkimi

- Pas instalimit, të kryhen testimet e komisionimit: rezistenca e tokëzimit, RCD, MCB dhe matja e rrymave të sistemit.
- Mirëmbajtja periodike (çdo 6 muaj) e baterive UPS rekomandohet sipas specifikimit të prodhuesit
- Dokumentimi i plotë teknik (as-built draëings) të dorëzohet Bashkisë Vlorë pas komisionimit

AK duhet të qartësojë persa me poshtë:

- ***A është detyrë e OE verifikimi i disponueshmërisë së rrjetit elektrik 230V OSHEE afër secilës pikë parkimi?***
- ***A do të kryhen nga OE testimet e komisionimit rezistenca e tokëzimit, RCD, MCB dhe matja e rrymave të sistemit.***

Nëse po, nevojitet të ndermerren masat e nevojshme për pasqyrimin e zerit testim në:

o Shtojca 2, Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit

o Shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK-së

o Shtojca 10, Preventivi

- ***Per sa periudhe kohore duhet kryer mirëmbajtja e baterive UPS, duke qenë se dokumenti nuk jep një periudhe shteruese kur perfundon ky shërbim.***

Te merren masat për të përlogaritur koston e këtij shërbimi në zerin e mirëmbajtjes:

o Shtojca 2, Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit

o Shtojca 6, Grafiku sipas Kërkesave të AK-së

o Shtojca 10, Preventivi

Ne lidhje me Ankesat e mesiperme, me keqardhje konstatojmë se dokumentacioni përket përfaqësuesit të kësaj kompanie dhe të domosdoshëm për kuptimin dhe vlerësimin e saktë të shërbimit në fjalë, cka kërkon një vëmendje të vecantë përtej një kërkesë për sqarim drejtuar AK. Kjo mungesë ve në pikëpyetje serioze nivelin e përgatitjes profesionale në lidhje me hartimin e termave të Specifikimeve teknike, veçanërisht duke marrë parasysh vlerën që ai përfaqëson.

Shërbimet e këtij niveli kërkojnë një përgatitje teknike të plote dhe të detajuar, në mënyrë që çdo Operator Ekonomik të ketë mundësinë të kuptojë qartë të gjitha komponentet dhe kërkesat e shërbimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet një llogaritje reale e kostove dhe të sigurohet një konkurrencë e ndershme dhe transparente mes pjesëmarrësve në procedurë. Kërkojmë: Pranimin e ankesës sonë.

Gjithashtu AK të percaktojë nëse do të jetë OE përgjegjës për sigurimin e lejeve/autorizimeve të nevojshme për punimet civile, verifikimet nga OSHEE etj, në funksion të realizimit të këtij projekti.

AK në Dokumentin Projekt _Parkimeve, ka cituar dhe përcaktuar se do të jenë 4 set parkime ku nga projekti nuk jepen detaji mbi sasinë e posteve të parkimit si dhe nga ana tjetër vërehet në projekt se janë dizenuar 2(dy) sisteme parkimi. Dallohet qartë që kemi 2Hyrje dhe 2 dalje parkimi. Pra në total nuk kemi një set pajisjesh por 2 sete pajisjesh. Të saktësohet që do të jenë 2(dy) sisteme parkimi apo 1(një) sistem parkimi. Të saktësohet dhe plan vendosja e zerave 19 dhe 20.

Dokumentat “Specifikime teknike”, “Relacion teknik Elektrik Vlorë Parking”, “Projekti Parkime me pagesë 2026”, përmbajnë mangësi të rëndësishme në specifikime teknike, si dhe janë hartuar në mënyrë të paqartë dhe konfuzuese për Operatorët Ekonomikë të interesuar.

Të rishikohen dhe modifikohen specifikimet teknike sipas kërkesave tona.

Të rishikohet procedura e hartimit të specifikimeve teknike, fondit limit dhe gjendjes aktuale të pajisjeve objekt prokurimi.

III.6.3 Neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se :

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.

III.6.4. Në nenin 15 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se:

- Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.
- Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:
- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- preventiv të hollesishëm
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.etj

III.6.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit në përcaktimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe si rrjedhojë është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me shërbimin e kërkuar. Është detyrë e njësisë përkatëse të mirëargumentojnë kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike me qëllim që të jenë sa më të plota dhe të sakta, të japin informacion të mjaftueshëm për operatorët ekonomikë të cilët do të ofertojnë në kryerjen e shërbimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar informacionit të autoritetit kontraktor, në lidhje me pikat sipërcituar të ankesës gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi specifikimet teknike dhe kërkesat e AK në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Komisioni gjykon se është në të drejtën e operatorëve ekonomikë të bëjnë ankesa dhe t'i argumentojnë ato në lidhje me dokumentacionin e procedurës së prokurimit se si ndikojnë në procesin e dorëzimit të ofertave në procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

Nga shqyrtimi i ankesës Komisioni vëren se operatori ekonomik ka argumentuar qartë pasaktësitë e konstatuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor, por në thelb janë paqartësi dhe pasaktësi në hartimin e dokumenteve objekt ankimi si vijon: Specifikimet Teknike, Artikujt pjesë e Preventivit, Relacionit Teknik, dokumente që sipas Autoritetit Kontraktor janë të domosdoshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.

Gjithashtu, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, KPP vëren, se autoriteti kontraktor, në informacionin e përcjellë në lidhje me trajtimin e ankesës me Vendimin e KSHA-së nuk ka argumentuar qëndrimin kundër mbi pretendimet sipërcituar në këtë pikë të ankesë, madje konstatohet se AK nuk e ka cekur në tërësi pikën e fundit të ankesës por pjesërisht, në përfundim të Vendimit të KSHA-së është shprehur se e pranon pjesërisht mbi modifikime dhe sqarime të dokumenteve të tenderit. Komisioni gjykon se Vendimi i KSHA-së me argumentimet e tij është i paqartë dhe konfuz.

Komisioni në referim të dokumenteve të dosjes administrative dhe në kuadër të garantimit e respektimit të parimeve të transparencës, barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomikë dhe konkurrencës së ndershme, kërkon që Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike, të japë sqarime të plota dhe shteruese lidhur me paqartësitë e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik.

Sqarimet e detajuara janë të domosdoshme për të siguruar një kuptim të saktë të kërkesave dhe specifikimeve teknike të procedurës si dhe për të shmangur interpretime të ndryshme që mund të ndikojnë në përgatitjen e ofertës dhe në zhvillimin në kohë të procedurës së prokurimit, por edhe për një proces vlerësimit sa më të drejtë të ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO.

Duke qene se operatori ekonomik ka paraqitur pyetje dhe paqartësi konkrete në lidhje me sa më sipër cituar në pikën III.6 e në vijim, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktor ka detyrimin ligjor të japë përgjigje të qarta, të argumentuara në mënyrë shteruese për çdo pretendim të ankimuesit për të siguruar dhe garantuar ligjshmërinë e procedurës si edhe realizimin në kohë të saj.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dhënia e sqarimeve por edhe modifikimet nga autoriteti kontraktor në tabelave përkatëse objekt ankimi është mëse e domosdoshme dhe këto sqarime në kuptim të nenit 75 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndyshuar, duhet të publikohen në shtojcën për ndryshimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me qëllim që operatori ekonomik ankimues si dhe të gjithë operatorët e tjerë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto modifikime dhe sqarime.

Sa më lart argumentuar pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndyshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së operatorit ekonomik “QuantXIT Solutions” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, *Mallra*, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Të pranojë pjesërisht pretendimet e ankesës për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të këtij Vendimi me publikimin e shtojcës përkatëse.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

